



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE**

U D H Ë Z I M

Nr. _____, datë _____.2026

**PËR STRUKTURËN, ADMINISTRIMIN, PËRDTËSIMIN DHE PUBLIKIMIN
E REGJISTRIT TË LOBIMIT**

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 8 të ligjit nr. 12/2026 “Për lobimin në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “Ligji”), Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Komisioneri”),

U D H Ë Z O N:

**KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1
Objekti**

Ky udhëzim përcakton strukturën, mënyrën e administrimit, si dhe procedurat për përditësimin dhe publikimin e të dhënave në Regjistrin e Lobimit (në vijim “Regjistri”), në zbatim të Ligjit.

**Neni 2
Qëllimi**

Qëllimi i këtij udhëzimi është të rregullojë administrimin, përditësimin dhe publikimin e të dhënave në Regjistër, me qëllim garantimin e transparencës së veprimtarisë së lobimit dhe informimin e publikut, në përputhje me Ligjin dhe legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.

**Neni 3
Fusha e zbatimit**

1. Ky udhëzim zbatohet për të gjitha subjektet e Ligjit dhe proceset që lidhen me krijimin, administrimin, funksionimin, përditësimin dhe publikimin e të dhënave në Regjistrin e Lobimit.
2. Në veçanti, ky udhëzim zbatohet për:

- a) lobistët, persona fizikë ose juridikë, që kërkojnë regjistrim ose janë të regjistruar në Regjistër;
- b) përfituesit e lobimit, në rastet e parashikuara nga Ligji;
- c) zyrtarët publikë, sipas nenit 3 të Ligjit;
- ç) strukturat përgjegjëse pranë Komisionerit që administrojnë, përditësojnë dhe publikojnë të dhënat në Regjistër.

Neni 4 **Përkufizime**

Për qëllime të këtij udhëzimi, përveç termave të përcaktuar në nenin 4 të Ligjit, zbatohen edhe këto përkufizime:

- a) *“Profili i lobistit”* është tërësia e të dhënave të regjistruara në Regjistër, që identifikojnë lobistin dhe pasqyrojnë statusin e tij, veprimtarinë e deklaruar të lobimit dhe informacionin tjetër të parashikuar në Ligj dhe në këtë udhëzim.
- b) *“Përditësim i të dhënave”* është çdo ndryshim, plotësim ose korrigjim i të dhënave të regjistruara në Regjistër.
- c) *“Gjurmë auditimi”* (audit trail) është evidenca elektronike kronologjike e veprimeve të kryera në Regjistër, e cila mundëson identifikimin e përdoruesit, datës dhe orës së veprimit, natyrës së veprimit të kryer dhe ndryshimeve të bëra mbi të dhënat e regjistruara.

Neni 5 **Parimet**

Administrimi i Regjistrit bazohet në këto parime:

- a) Ligjshmëria – administrimi i Regjistrit kryhet në përputhje me Ligjin, këtë udhëzim dhe legjislacionin në fuqi.
- b) Transparenca – të dhënat që Ligji parashikon si të publikueshme janë të aksesueshme për publikun, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- c) Saktësia – të dhënat e regjistruara duhet të jenë të plota, të sakta dhe të përditësuara, ndërsa përgjegjësia për saktësinë, plotësinë dhe përditësimin e tyre i takon subjektit që i deklaron.
- ç) Minimizimi i të dhënave personale – përpunohen dhe publikohen vetëm ato të dhëna personale që janë të nevojshme për funksionimin e Regjistrit dhe që lejohen nga Ligji, në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.
- d) Siguria – administrimi i Regjistrit garanton konfidencialitetin, integritetin dhe disponueshmërinë e të dhënave, nëpërmjet masave të përshtatshme teknike dhe organizative.
- dh) Përgjegjshmëria institucionale – strukturat përgjegjëse pranë Komisionerit ushtrojnë kompetencat e tyre në mënyrë të përgjegjshme dhe në përputhje me Ligjin dhe këtë udhëzim.
- e) Gjurmueshmëria – çdo veprim i kryer në Regjistër dokumentohet dhe mund të identifikohet në çdo kohë nëpërmjet gjurmës së auditimit.

KREU II

STRUKTURA E REGJISTRIT DHE FUSHAT E TË DHËNAVE

Neni 6

Organizimi i Regjistrit

1. Regjistri organizohet si një bazë elektronike publike e të dhënave, e strukturuar në module funksionale të ndërlidhura, të cilat mundësojnë administrimin, identifikimin, ndjekjen dhe verifikimin e veprimtarisë së lobimit.
2. Regjistri organizohet në mënyrë që të sigurojë lidhjen ndërmjet:
 - a) profileve të lobistëve;
 - b) përfituesve të lobimit dhe marrëdhënieve të tyre me lobistët;
 - c) kontratave të lobimit;
 - ç) deklarimeve periodike të lobistëve;
 - d) raportimeve të zyrtarëve publikë mbi kontaktet e zhvilluara me lobistët.
3. Struktura e Regjistrit hartohet në përputhje me kërkesat e Ligjit dhe të këtij udhëzimi, duke garantuar gjurmueshmërinë, integritetin dhe aksesin e kontrolluar në të dhëna.
4. Regjistri zhvillohet, përditësohet dhe mirëmbahet në përputhje me standardet teknike të sigurisë dhe me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.
5. Regjistri ndërtohet, kur është teknikisht e realizueshme dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi, në mënyrë që të jetë i ndërveprueshëm me regjistra të tjerë publikë.

Neni 7

Të dhënat bazë të Regjistrit për lobistin

1. Përveç të dhënave të përcaktuara në Ligj, për çdo person fizik ose juridik që ushtron veprimtari lobimi regjistrohen edhe numri unik i identifikimit, data e regjistrimit fillestar, si dhe çdo çregjistrim dhe reregjistrim i mëvonshëm, së bashku me datat përkatëse.
2. Të dhënat e Regjistrit përditësohen sa herë që ndodhin ndryshime në të dhënat e regjistruara, brenda afateve dhe sipas procedurave të përcaktuara në Ligj dhe në këtë udhëzim.

Neni 8

Funksionet minimale të Regjistrit

1. Regjistri organizohet dhe funksionon në mënyrë të tillë që të mundësojë përdorimin e tij nga Komisioneri, subjektet e Ligjit dhe publiku, secili sipas rolit, kompetencave dhe nivelit të aksesit të përcaktuar në Ligj dhe në këtë udhëzim. Për këtë qëllim, Regjistri mundëson kërkimin, konsultimin dhe përdorimin efektiv të të dhënave.
2. Regjistri mundëson, të paktën, kërkimin sipas një ose më shumë prej kriterëve të mëposhtme:
 - a) emrit të lobistit ose numrit unik të identifikimit, sipas rastit;
 - b) emrit të përfituesit të lobimit;
 - c) çështjet ose temat e lobimit;

- c) institucionit publik ndaj të cilit ushtrohet veprimtaria e lobimit;
 - d) periudhës kohore të veprimtarisë së lobimit;
 - dh) objektit të veprimtarisë së lobimit, përfshirë dokumentin, aktin ose procesin vendimmarrës, kur është i identifikueshëm;
 - e) statusit aktual të lobistit në Regjistër.
3. Për çdo lobist, Regjistri ofron një profil publik që përfshin të dhënat e publikueshme, sipas nenit 8 të Ligjit, duke përfshirë, sipas rastit:
- a) të dhënat identifikuese të publikueshme;
 - b) përfaqësuesin ligjor dhe, kur është e zbatueshme, personat që ushtrojnë veprimtarinë e lobimit në emër të personit juridik;
 - c) përfituesin ose përfituesit e lobimit;
 - ç) çështjet ose temat e lobimit;
 - d) institucionet publike ose kategoritë e zyrtarëve publikë me të cilët janë vendosur kontakte lobimi;
 - dh) deklaratimet periodike të lobistit;
 - e) raportimet e zyrtarëve publikë, në rastet e parashikuara nga Ligji.
4. Regjistri mundëson gjenerimin e ekstrakteve elektronike të të dhënave të publikuara.
5. Regjistri mundëson aksesin në të dhënat e publikuara në formate të ripërdorshme, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 9

Pasqyrimi i kontratave dhe veprimtarisë së lobimit

1. Regjistri pasqyron, për çdo veprimtari lobimi, të dhënat përkatëse, në përputhje me Ligjin, duke përfshirë, të paktën:
 - a) të dhënat kryesore të kontratës së lobimit;
 - b) çështjen ose temën e lobimit;
 - c) institucionin publik me të cilin janë vendosur kontakte lobimi;
 - ç) përfituesin e lobimit, kur veprimtaria ushtrohet në emër të tij;
 - d) lidhjen me deklaratimet periodike të lobistit dhe të dhënat e tjera të regjistruara në Regjistër.
2. Kur kontrata e lobimit ose dokumentacioni shoqërues përmbajnë të dhëna që nuk janë të publikueshme sipas Ligjit, ato administrohen nga Komisioneri vetëm për qëllime verifikimi, kontrolli dhe mbikëqyrjeje dhe nuk bëhen publike.

KREU III

MËNYRA E ADMINISTRIMIT DHE PROCEDURAT E PËRDITËSIMIT TË TË DHËNAVE NË REGJISTRIN E LOBITIT

Neni 10

Administrimi dhe kompetencat

1. Regjistri administrohet nga struktura përgjegjëse pranë Komisionerit, e cila ushtron funksionet administrative dhe teknike të nevojshme për administrimin, përditësimin, publikimin dhe mirëmbajtjen e tij.

2. Struktura përgjegjëse për administrimin e Regjistrit ushtron, në veçanti, këto kompetenca:
 - a) pranon dhe administron kërkesat, deklaratimet dhe dokumentacionin e paraqitur nga subjektet e Ligjit;
 - b) regjistron, përpunon, përditëson dhe korrigjon të dhënat, në përputhje me Ligjin dhe këtë udhëzim;
 - c) kryen verifikimin paraprak të plotësisë dhe rregullsisë së dokumentacionit të paraqitur;
 - ç) publikon të dhënat që, sipas Ligjit dhe këtij udhëzimi, janë të publikueshme;
 - d) administron gjurmën e auditimit për çdo veprim të kryer në Regjistrë;
 - dh) monitoron funksionimin e Regjistrit dhe evidenton parregullsitë teknike ose administrative.
3. Administrimi i Regjistrit realizohet mbi bazën e ndarjes së roleve dhe përgjegjësi, duke garantuar që regjistrimi, përditësimi, publikimi dhe verifikimi i të dhënave kryhen vetëm nga persona të autorizuar, në përputhje me kompetencat e tyre.
4. Çdo akses ose veprim i kryer në Regjistrë dokumentohet dhe regjistrohet në mënyrë që të garantohet identifikueshmëria dhe gjurmueshmëria e tij.
5. Kur administrimi i Regjistrit përfshin më shumë se një strukturë përgjegjëse, Komisioneri përcakton ndarjen e detyrave dhe mënyrën e bashkërendimit ndërmjet tyre.

Neni 11

Afatet dhe procedurat e përditësimit të të dhënave

1. Përditësimi i të dhënave në Regjistrë kryhet brenda afateve të përcaktuara në Ligj dhe në këtë udhëzim, duke garantuar pasqyrimin e saktë, të plotë dhe në kohë të tyre.
2. Lobisti njofton Komisionerin për çdo ndryshim të të dhënave të tij që pasqyrohen në Regjistrë brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e ndryshimit, përveç rasteve kur Ligji parashikon një afat të posaçëm. Komisioneri përditëson të dhënat në Regjistrë në përputhje me afatin e përcaktuar në pikën 2 të nenit 8 të Ligjit.
3. Çdo përditësim i të dhënave regjistrohet në Regjistrë dhe përmban, të paktën:
 - a) datën e përditësimit;
 - b) arsyen e përditësimit;
 - c) identifikimin e personit ose strukturës përgjegjëse që ka kryer veprimin.
4. Regjistri ruan historikun e çdo përditësimi të kryer mbi të dhënat, në mënyrë që të garantohet gjurmueshmëria e ndryshimeve.
5. Të dhënat e Regjistrit pasqyrojnë, sipas rastit, regjistrimin, çregjistrimin ose reregjistrimin e lobistit, në përputhje me Ligjin dhe këtë udhëzim.

KREU IV
PROCEDURAT E PUBLIKIMIT TË TË DHËNAVE NË REGJISTRIN E
LOBIMIT

Neni 12
Rregullat e publikimit

1. Në Regjistër publikohen vetëm ato kategori të të dhënave që Ligji parashikon si të publikueshme, me qëllim garantimin e transparencës së veprimtarisë së lobimit dhe informimin e publikut.
2. Përpunimi dhe publikimi i të dhënave personale kryhet në masën e nevojshme për përmbushjen e qëllimeve të parashikuara në Ligj dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.
3. Nuk publikohen të dhëna ose kategori të dhënash, kur publikimi i tyre:
 - a) nuk parashikohet nga Ligji;
 - b) cenon të drejtat dhe liritë themelore të personave fizikë;
 - c) bie ndesh me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.
4. Përpara publikimit të të dhënave, struktura përgjegjëse verifikon përputhshmërinë e tyre me kërkesat e Ligjit dhe të legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.
5. Të dhënat që nuk janë të publikueshme administrohen nga Komisioneri vetëm për qëllime regjistrimi, verifikimi, kontrolli dhe mbikëqyrjeje, në përputhje me Ligjin dhe legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.
6. Publikimi i të dhënave personale në Regjistër kryhet në përputhje me kërkesat e Ligjit dhe të legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, duke respektuar parimet e nevojshmërisë dhe proporcionalitetit.
7. Në rast të çregjistrimit të lobistit nga Regjistri, të dhënat e publikuara në Regjistër vazhdojnë të jenë të aksesueshme për publikun për një periudhë prej 5 (pesë) vjetësh nga data e çregjistrimit, duke pasqyruar statusin e lobistit si të çregjistruar. Pas përfundimit të kësaj periudhe, të dhënat nuk janë më të aksesueshme publikisht.
8. Ruajtja e të dhënave personale të administruara nga Komisioneri kryhet për aq kohë sa është e nevojshme për përmbushjen e qëllimeve të parashikuara në Ligj dhe ushtrimin e kompetencave të Komisionerit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

KREU V
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 13
Mbikëqyrja dhe monitorimi

1. Komisioneri, nëpërmjet strukturave përgjegjëse, monitoron dhe mbikëqyr zbatimin e këtij udhëzimi dhe administrimin e Regjistrit, në përputhje me kompetencat e përcaktuara në Ligj.

2. Strukturat përgjegjëse pranë Komisionerit marrin masat e nevojshme për zbatimin e këtij udhëzimi dhe për garantimin e administrimit të rregullt të Regjistrit.

Neni 14
Dispozitë tranzitore

Deri në ngritjen dhe vënien në funksion të Regjistrit, të dhënat që, sipas Ligjit dhe këtij udhëzimi janë të publikueshme në Regjistër, publikohen në faqen zyrtare të Komisionerit, në formate të hapura dhe të ripërdorshme, në përputhje me legjislacionin në fuqi për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik.

Neni 15
Hyrja në fuqi

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KOMISIONERI
Besnik Dervishi